

## **Dëshmorët Klaudi, Diodori, Viktori, Viktorini, Theodhora, Didimi, Papi, Serapioni, Thermi**



E hënë, 5 prill 2021 – Shenjtori i ditës.

**JEMI NË KRESHMËN E MADHE TË PASHKËS**

Dëshmorët Klaudi, Diodori, Viktori, Viktorini, Theodhora, Didimi, Papi, Serapioni, Thermi etj.

Dëshmorët Theodhora dhe Didimi.

Në kohën e persekutimeve të Dioklecianit dhe Maksimianit (289-305) ndaluan në Aleksandri një virgjëreshë të përkushtuar të Perëndia, Theodhorën. Kishte rrëfyer me kurajë Krishtin përpara guvernatorit dhe kështu e kishin futur në një shtëpi prostitucioni.

Burri i parë që shkoi për të abuzuar me të ishte një ushtarak me emrin Didim. Nga pastërtia rrezatuese e vajzës, ai u kthye nga qëllimet e tij të këqija dhe e veshi vajzën me rrobat ushtarake, i dha edhe armët e tij që të mund të dilte prej andej e gjallë dhe pa u prekur. Kur kjo gjë u zbulua, e morën Didimin dhe e çuan para qeveritarit.

Kur i kërkuan arsyen e asaj që kishte bërë, ai u përgjigj qetësisht se priste një kurorë të dyfishtë: nga njëra anë se kishte çliruar nusen e Krishtit nga njerëzit e shthurur, dhe nga ana tjetër se priste martirizimin e tij. Ia prenë kokën dhe trupin ia dogjën në zjarr. Edhe shën Theodhora mori kurorën e martires duke u djegur e

gjallë.

[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)